




Pranuar / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivery	03.10.2023	viti god year	3
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSIJK	6369/2023		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1088/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Jeton Koca dhe Arditë Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1088/2023 të datës 17.08.2023 të parashtruar nga ankuesi [] të cilin me autorizim e përfaqëson avokate Vjosa Ismajli rr. "Fan Noli" Nr. 3 Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1088/2023 e datës 17.08.2023 e parashtruar nga ankuesi

Nëpunësi civil [] i punësuar në pozitën "Zyrtar i Lartë Certifikues" në kuadër të Departamentit Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, sipas Akt Emërimit me numër AE. Nr. 47/2022 të datës 13.06.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që ti bëhet klasifikimi sipas Rregullosës Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil i nga pozita aktuale "Zyrtar i Lartë Certifikues" në Drejtues i Ulët.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullosës Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.08.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje

në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa Këshilli më datë 25.08.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5695/2023 të datës 17.08.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizim nga E.I. për avokaten V.I. i datës 15.08.2023; Letërnjoftim i E.I.; Vërtetim për E.I. me numër protokolli 585 i datës 09.02.2023; Lista e pagave Janar-Prill 2023; Kërkesë për klasifikim të pozitës i E.I. me numër protokolli 609 i datës 10.02.2023; E-mail nga V.B. për E.I. i datës 20.07.2023; E-mail nga B.B. për V.B. i datës 20.07.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 22.08.2023; Përgjigje në ankesë e datës 25.08.2023; Akt Emërim i E.I. me numër AE. Nr. 47/2022 i datës 13.06.2022; Akt Emërim i E.I. me numër Nr. ref. 347/2013 i datës 03.05.2023; E-mail nga E.I. për Burimet Njerëzore MPJD i datës 19.07.2023; Kërkesë për pagesë retroaktive formulari i të dhënave për listën e pagave shkurtmars 2023 i datës 07.04.2023; E-mail nga B.B. për V.B. i datës 20.07.2023; E-mail nga V.B. për B.B. i datës 20.07.2023; E-mail nga A.F. për B.B. i datës 08.08.2023; E-mail nga M.Q. për Z.K. i datës 28.02.2023; E-mail nga Z.K. për N.Sh. etj. i datës 27.02.2023; E-mail nga E.H. për Sh.L. i datës 15.02.2023; E-mail nga E.H. për Sh.L. i datës 13.02.2023; E-mail nga E.H. për Sh.L. i datës 25.01.2023; E-mail nga E.H. për Sh.L. i datës 19.01.2023; E-mail nga E.H. për Sh.L. i datës 16.01.2023; E-mail nga V.B. për C.Z. i datës 04.09.2023; Konkurs nga Komuna e Prishtinës Lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Zyrtar Certifikues" i datës 02.09.2023; Konkurs nga Komuna e Deçanit Lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Zyrtar Certifikues" i datës 03.08.2023; Konkurs nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit Lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Zyrtar Certifikues" i datës 26.05.2023; E-mail nga V.B. për C.Z. i datës 02.10.2023; E-mail nga V.B. për E.I. i datës 08.08.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e palejuar, *sepse*:

Bazuar në shkresat e lëndës konkretisht Aktin e Emërimit me numër AE. Nr. 47/2022 të datës 13.06.2022, rezulton se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës "Zyrtar i Lartë Certifikues", në kuadër të Departamentit Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me koeficient të pagës nëntë (9) sipas sistemit të vjetër të pagave. Ndërsa ankuesi me datë 10.02.2023 me numër protokolli 609 ka bërë kërkesë për klasifikim të pozitës tek Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Ankuesi, me datë 17.08.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që ti bëhet klasifikimi sipas Rregullores Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil i nga pozita aktuale "Zyrtar i Lartë Certifikues" në Drejtues i Ulët.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, konstaton se sipas nenit 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është përcaktuar se: "Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës

administrative (në vijim: "heshtja administrative")", si rrjedhojë ankuesi ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar lidhur me klasifikimin sipas Rregullores Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil i nga pozita aktuale "Zyrtar i Lartë Certifikues" në Drejtues i Ulët.

Duke marr parasysh afatin për parashtrimin e ankesës ndaj aktit administrativ, Kolegji i Këshillit, ju referua nenit 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme ku përcaktohet se " 1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 2. Pala e tretë që nuk ka marrë pjesë në procedurën administrative dhe nuk i është njoftuar akti, mund të parashtrorë ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur ka marrë apo duhej të kishte marrë dijeni për aktin, por jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga nxjerrja e aktit. 3. Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ", prandaj meqenëse ankuesi me datë 10.02.2023 me numër protokolli 609 ka bërë kërkesë për klasifikim të pozitës tek Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar më datë 17.08.2023, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është parashtruar në kundërshtim me afatin e përcaktuar si më lartë, nga kjo rrjedh se ankesa e ankuesit është e pas afatshme dhe si e tillë është e palejuar në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.


Andaj, nisur nga konstatimet si me lartë, Kolegji në mbështetje të nenit 129 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.nr.1088/2023

Çlirim Zeka


Procesmbajtës


Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësueses së autorizuar të ankuesi
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

